



NJOHJA E ATËSISË/MËMËSISË

Çdo fëmijë ka nevojë për një baba

Përmbajta

Vështrim i përgjithshëm	1
Përfitimet e përcaktimit të atësisë/mëmësisë	2
Nuk jeni të sigurt se cili është prindi tjetër?	3
Dokumentet e nevojshme	3
Formulari i Njohje së Atësisë/Mëmësisë	3
Kush duhet ta nënshkruajë formularin AOP?	4
Për një të porsalindur	4
Pasi foshnja del nga spitali	4
Kur nuk duhet të nënshkruhet AOP-ja	5
Kundërshtimi i njohjes së atësisë/mëmësisë	5
Dhënia e Urdhrit të Njohjes së Atësisë ose e Urdhrit të Njohjes së Atësisë/Mëmësisë nga gjykata	6
Arsyet e përcaktimit të atësisë/mëmësisë ose atësisë në gjykatë ..	7
Si të depozitoni një kërkesë për njohjen e atësisë/mëmësisë	7
Çfarë ndodh në një seancë gjyqësore për njohjen e atësisë/mëmësisë ose atësisë?	8
Certifikata e lindjes dhe dokumentet ligjore	8
Të dhënat e kontaktit	9

Vështrim i përgjithshëm

Njohja e atësisë/mëmësisë është procesi i përcaktimit të prindërve ligjorë të një fëmije.

- Nëse fëmija ka lindur nga prindër të martuar dhe është ngjizur në mënyrë natyrale, nuk është nevoja të njihet atësia/mëmësia sepse të dy presupozohen se janë prindër të fëmijës, përveçse kur kjo gjë kundërshtohet në gjykatë.
- Nëse fëmija ka lindur nga prindër të pamartuar dhe është ngjizur ose në mënyrë natyrale, ose duke përdorur metodat e riprodhimit të asistuar, atëherë është e nevojshme të njihet atësia/mëmësia për të përcaktuar të drejtat prindërore dhe detyrimin ligjor për mbështetjen e fëmijës.

Nëse prindërit nuk janë të martuar, prindi tjetër nuk ka asnjë detyrim ligjor të paguajë për mbështetjen ligjore të fëmijës dhe nuk ka të drejtë ligjore për të marrë kujdestarinë ose vizituar fëmijën, deri kur të cilësohet ligjërisht si prindi tjetër i fëmijës.

NJOHJA E ATËSISË/MËMËSISË REALIZOHET NË DY MËNYRA:

METODA	KUR TA PËRDORNI
1. Nënshkrimi dhe pranimi i formularit të njohjes së atësisë/mëmësisë	Atësia/mëmësia nuk është e diskutueshme dhe është vullnetare
2. Dhënia e Urdhrit të Njohjes së Atësisë ose e Urdhrit të Njohjes së Atësisë/Mëmësisë nga gjykata	<ul style="list-style-type: none">• Deklaroni një baba si prind ligjor (Urdhri i Njohjes së Atësisë);• Deklaroni një prind të synuar si prind ligjor (Urdhri i Njohjes së Atësisë/Mëmësisë).• Përdoret kur atësia/mëmësia është e diskutueshme, janë përdorur metodat e riprodhimit të asistuar, është i ndërlikuar dhe jovullnetar.

Përfitimet e përcaktimit të atësisë/mëmësisë

Përfitimet e përcaktimit të atësisë/mëmësisë ligjore të një fëmije janë:

Për prindërit

- Ndarje e përgjegjësive prindërore
- Siguri më e lartë financiare për familjen nëse është hapur çështje për mbështetjen financiare të fëmijës
- Përcaktimi ligjor i të drejtave dhe përgjegjësive prindërore për prindërit biologjikë ose prindërit e synuar ligjorë
- Emri shfaqet në certifikatën e lindjes së fëmijës
- E drejta për të kërkuar vizita me urdhër të gjykatës dhe/ose kujdestari
- E drejta për t'u konsultuar për procese birësimi ose procese të tjera ligjore që lidhen me fëmijën

Për fëmijën

- Regjistrimi ligjor i identitetit të prindit tjetër
- Të dy emrat e prindërve në certifikatën e lindjes
- Informacion për historikun mjekësor të familjes
- Mbështetje financiare nga të dy prindërit nëse është hapur çështje për mbështetjen financiare të fëmijës
- Përfitime nga sigurimet mjekësore, shoqërore dhe veterane, si dhe pension ushtarak nga prindi tjetër
- Të drejta trashëgimie nëse prindi tjetër vdes



Nuk jeni të sigurt se cili është prindi tjetër?

Nëse ndonjëri prej prindërve ka dyshime për identitetin e prindit tjetër (prindi që nuk e ka lindur fëmijën), mos e nënshkruani Formularin e Njohjes së Atësisë/Mëmësisë. Mund të kërkonti një test ADN-je me kosto të ulët, gjë që i vihet në dispozicion si prindërve të martuar, ashtu edhe prindërve të pamartuar. Pyesni regjistruarin e lindjeve në spital ose kontaktoni Zyrën e Shërbimeve të Mbështetjes Financiare të Fëmijës (OCSS) në numrin 929-221-5008 për një laborator të certifikuar nga shteti i Nju-Jorkut.



Nëse testi i ADN-së e identifikon prindin tjetër, prindërit e pamartuar duhet ta njohin atësinë/mëmësinë duke nënshkruar Formularin e Njohjes së Atësisë/Mëmësisë ose dorëzuar një kërkesë në gjykatë për njohjen e atësisë/mëmësisë. Ndonëse testi i ADN-së mund të përcaktojë identitetin e prindërve biologjikë, nuk e përcakton dot atësinë/mëmësinë ligjore.

Dokumentet e nevojshme

Në spitalin ose në maternitetin ku ka lindur fëmija juaj, do t'ju pyesin për statusin martesor për të përcaktuar nëse dëshironi të bëni njohje të atësisë/mëmësisë duke plotësuar Formularin e Njohjes së Atësisë/Mëmësisë.

Duhet të tregoni mjet identifikimi me fotografi, pasi duhet të dëshmohet se keni nënshkruar Formularin e Njohjes së Atësisë/Mëmësisë.

Nëse jeni të martuar, duhet të sillni certifikatën aktuale të martesës ose vendimin e divorcit, nëse e keni një të tillë.

Formulari i Njohjes së Atësisë/Mëmësisë

Formulari i [Njohjes së Atësisë/Mëmësisë](#) është një formular që prindërit mund ta përdorin vullnetarisht për të përcaktuar atësinë/mëmësinë ligjore të fëmijës, pa qenë e nevojshme t'i drejtohen gjykatës. Këtë formular të detyrueshëm me ligj duhet ta plotësoni me kujdes, për të shmangur refuzimin e tij pas depozitimit për arsye pasaktësie.



Kush duhet ta nënshkruajë formularin AOP?

Prindërit duhet të nënshkruajnë Formularin e Njohjes së Atësisë/Mëmësisë kur:

- Fëmija është ngjizur në mënyrë natyrale dhe prindërit nuk ishin të martuar në kohën e lindjes së fëmijës.
- Fëmija është ngjizur duke përdorur metodat e riprodhimit të asistuar (për shembull, me farëzim artificial ose fertilizim in vitro).
- Prindërit janë adoleshentë të moshës 18 vjeç ose më të vegjël (nuk kanë nevojë për pëlqimin e prindërve përkatës).
- Prindërit janë imigrantë, përfshi ata që nuk janë qytetarë dhe ata që janë të padokumentuar. Nuk nevojitet numri i sigurimeve shoqërore. Prindërit nuk do të pyeten për statusin e tyre të imigracionit dhe informacioni nuk do të ndahet me Shërbimet Amerikane të Nënshkruarës dhe Imigracionit.

SHËNIM:

Dokumenti që tregon pëlqimin e përbashkët të të dy prindërve për të ngjizur dhe rritur një fëmijë duke përdorur metodat e riprodhimit të asistuar, zakonisht mjafton për të përcaktuar atësinë/mëmësinë ligjore të fëmijës dhe nuk kërkohet Formulari i Njohjes së Atësisë/Mëmësisë.

Për një të porsalindur

Nëse të dy prindërit bien dakord, mund ta nënshkruajnë Formularin e Njohjes së Atësisë/Mëmësisë (AOP) sapo të lindë fëmija. Formularët e Njohjes së Atësisë/Mëmësisë mund të gjenden te zyra ose klinika mjekësore ku merrni kujdesin tuaj prenatal, në spital ose në maternitetin ku ka lindur fëmija juaj. Nuk është e nevojshme që prindërit ta nënshkruajnë formularin në të njëjtën kohë ose në të njëjtin vend.

Pasi foshnja del nga spitali

Atësia/mëmësia mund të njihet në çdo kohë pas daljes së foshnjës nga spitali. Një gjë e tillë është e vlefshme deri kur fëmija të mbushë 21 vjeç. Ju mund të përdorni Formularin e Njohjes së Atësisë/Mëmësisë që ju kanë dhënë në spitalin ku ka lindur foshnja juaj. Mund ta merrni një të tillë edhe nga Departamenti i Qytetit të Nju-Jorkut të Shëndetësisë dhe Higjienës Mendore (DOHMH) ose Zyra e Shërbimeve të Mbështetjes Financiare të Fëmijës, pranë Administratës së Qytetit të Nju-Jorkut të Burimeve Njerëzore (HRA). Gjenden edhe online në: <https://otda.ny.gov/programs/applications/5171.pdf>.



Formulari i plotësuar, i nënshkruar dhe i dëshmuar i Njohjes së Atësisë/Mëmësisë duhet t'i dërgohet ose sillet personit në adresën e mëposhtme:

New York City Department of Health and Mental Hygiene
Office of Vital Records/Corrections Unit – Room 144
125 Worth Street, Box 4
New York, NY 10013

KUR NUK DUHET TË NËNSHKRUHET AOP-JA

Mos e nënshkruani Formularin e Njohjes së Atësisë/Mëmësisë (AOP) nëse:

- Foshnja nuk ka lindur ende
- Ndonjëri prej prindërve nuk është i sigurt se cili është prindi tjetër
- Prindërit e fëmijës janë të martuar me njëri-tjetrin (atësia/mëmësia njihet automatikisht)
- Nëna është martuar ligjërisht me dikë që nuk është babai/prindi tjetër

Kundërshtimi i njohjes së atësisë/mëmësisë

Nëse njëri prej prindërve do të kundërshtojë një Formular të Njohjes së Atësisë/Mëmësisë pasi është depozituar pranë Departamentit të Shëndetësisë dhe Higjienës Mendore (DOHMH), kërkohet një seancë gjyqësore. Secili prind mund të depozitojë një kërkesë për pavlefshmërinë e njohjes së atësisë/mëmësisë.

Depozitimi i kërkesës për pavlefshmërinë e njohjes së atësisë/mëmësisë duhet të bëhet brenda afateve të caktuara kohore.

- Nëse prindi ishte 18 vjeç ose më i vogël në kohën e nënshkrimit të Formularit të Njohjes së Atësisë/Mëmësisë, ai duhet ta bëjë depozitimin sa më shpejt që të jetë e mundur 60 ditë pas nënshkrimit të Formularit të Njohjes së Atësisë/Mëmësisë, ose 60 ditë pasi t'i jetë përgjigjur ndonjë kërkesë gjyqate për fëmijën.
- Nëse prindi ishte 18 vjeç ose më i vogël në kohën e nënshkrimit të Formularit të Njohjes së Atësisë/Mëmësisë, ai duhet ta depozitojë atë 60 ditë pasi të ketë mbushur moshën 18 vjeçare ose 60 ditë pasi t'i jetë përgjigjur ndonjë kërkesë gjyqate lidhur me fëmijën, nëse prindi ishte këshilluar për të drejtën për të anuluar njohjen e atësisë/mëmësisë në një proces të lidhur me fëmijën.
- Nëse afati ka kaluar, ju mund ta dorëzoni kërkesën për të pavleftësuar njohjen e atësisë nëse prindi që depoziton kërkesën paraqet prova mashtrimi, kanosjeje ose gabimi fakti.

Sapo të jetë kundërshtuar në kohë njohja e atësisë, gjykata do të mbajë një seancë gjyqësore për të përcaktuar atësinë/mëmësinë e fëmijës dhe mund të urdhërojë kryerjen e një testi ADN-je ose markuesi gjenetik. Nëse gjykata përcakton se personi që ka nënshkruar Formularin e Njohjes së Atësisë/Mëmësisë nuk është prindi i fëmijës, atëherë do të pavleftësojë njohjen e atësisë.

Dhënia e Urdhrit të Njohjes së Atësisë ose e Urdhrit të Njohjes së Atësisë/Mëmësisë nga gjykata

Urdhri i Njohjes së Atësisë ose e Urdhrit të Njohjes së Atësisë/Mëmësisë është një urdhër gjykate që përcakton prindin ligjor.

- **Urdhri i Njohjes së Atësisë:** gjykata deklaron se babai është prindi ligjor i fëmijës;
- **Urdhri i Njohjes së Atësisë/Mëmësisë:** gjykata deklaron një prind të synuar ligjor si prindin e fëmijës, p.sh në rastet kur është përdorur riprodhimi i asistuar.



Arsyet e përcaktimit të atësisë/mëmësisë ose atësisë në gjykatë

Ju duhet t'i kërkonti gjykatës për çështjet familjare ta përcaktojë atësinë/mëmësinë nëse:

- Nuk është nënshkruar Formulari i Njohjes së Atësisë/Mëmësisë.
- Nëna është martuar me dikë që nuk është babai biologjik i fëmijës. Edhe nëse ajo nuk ka qenë në kontakt me bashkëshortin e saj dhe e di që nuk është babai i fëmijës, nevojitet seancë gjyqësore për ta përjashtuar atë dhe për ta njohur babain biologjik si babain ligjor.
- Prindërit janë në gjykatë për një proces lidhur me mbështetjen financiare të fëmijës dhe atësia/mëmësia nuk është përcaktuar ende.
- Ju jeni prindi i synuar ligjor.

Si të depozitoni një kërkesë për njohjen e atësisë/mëmësisë

Kërkesa për njohjen e atësisë ose atësisë/mëmësisë mund të depozitohet nga nëna, babai i supozuar, prindi ligjor i synuar, fëmija dhe kujdestari i tij.

Nëse fëmija po merr ndihmë ekonomike, Departamenti i Shërbimeve Sociale do të depozitojë një kërkesë kundër prindit të supozuar, për të kërkuar një urdhër për njohjen e atësisë dhe një urdhër për mbështetje financiare. Në disa raste, mund të depozitohet kërkesë për njohjen e atësisë/mëmësisë.

Kërkesa mund të përgatitet duke përdorur programin e Formularëve [DIY \(Do-It-Yourself\)](#) dhe më pas të depozitohet në gjykatë nëpërmjet Sistemit të Dërgimit të Dokumenteve Elektronike (EDDS) (<https://iappscontent.courts.state.ny.us/NYSCEF/live/edds.html>), ose duke shkuar vetë në gjykatë për të depozituar kërkesat.



Kujdestarët dhe individët e tjerë që nuk janë prindër mund ta depozitojnë kërkesën duke përdorur [Formularin 5-2](#) (Kërkesa e njohjes së atësisë/mëmësisë - person i ndryshëm nga prindi; përfaqësues i shoqërisë).



Çfarë ndodh në një seancë gjyqësore për njohjen e atësisë/mëmësisë ose atësisë

Gjykata do të dërgojë një fletëthirrje dhe do t'ju informojë mbi datën e planifikuar për seancën dëgjimore. Fletëthirrja dhe kërkesa duhet t'i dorëzohen palës tjetër.

Në seancën dëgjimore, të dy prindërit ose të gjitha palët do të paraqiten përpara magjistratit mbështetës në Gjykatën e Çështjeve Familjare pranë vendbanimit tuaj. Nëse nëna nuk ka qenë e martuar në momentin e ngjizjes ose lindjes së fëmijës dhe prindi tjetër pranon atësinë e fëmijës, atëherë lëshohet një urdhër për njohjen e atësisë.

Nëse ka ndonjë mosmarrëveshje apo dyshime rreth atësisë/mëmësisë, të dy prindërit dhe fëmija mund të detyrohen që të kryejnë analizën e markerëve gjenetikë ose testin e ADN-së. Këto teste janë të thjeshta. Një tampon merret nga të dy prindërit dhe nga fëmija. Rezultati i testit do të tregojë gjasat që ka prindi tjetër për të qenë prindi biologjik i fëmijës. Në bazë të rezultatit të testit dhe të provave të tjera, gjykata do të vendosë mbi çështjen e atësisë/mëmësisë së fëmijës dhe mund të lëshojë një urdhër të njohjes së atësisë.

Certifikata e lindjes dhe dokumentet ligjore

Kur përcaktohet atësia/mëmësia nga një Formular i Njohjes së Atësisë/Mëmësisë ose Urdhër i Njohjes së Atësisë apo Urdhër i Njohjes së Atësisë/Mëmësisë, këto dërgohen pranë Departamentit të Qytetit të Nju-Jorkut të Shëndetësisë dhe Higjienës Mendore (DOHMH) për regjistrim. Nga ana tjetër, ky i fundit u jep prindërve kopje të certifikuara të certifikatës së lindjes së fëmijës dhe Formularin e Njohjes së Atësisë/Mëmësisë. Nëse atësia ose mëmësia janë përcaktuar pas regjistrimit të certifikatës së lindjes, certifikata e lindjes do të ndryshohet me urdhër gjyqësor për të përfshirë emrin e prindit tjetër.

Departamenti i Qytetit të Nju-Jorkut të Shëndetësisë dhe Higjienës Mendore (DOHMH) e dërgon informacionin edhe pranë Zyrës së Regjistrimit të Atësisë së Pretenduar (PFR) të shtetit të Nju-Jorkut (termi "pretenduar" nënkupton termin "supozuar"). PFR mban një listë të prindërve që kanë përcaktuar atësinë/mëmësinë në shtetin e Nju-Jorkut.

TË DHËNAT E KONTAKTIT

Për të mësuar më shumë mbi përcaktimin e atësisë/mëmësisë, kontaktoni:

- Zyrтарin e regjistrimit të lindjes në spital ose në qendrën e lindjeve ku ka lindur fëmija juaj.
- Dërgojini një email Zyrës për Shërbimet e Mbështetjes Financiare për Fëmijën të HRA në adresën dcse.cseweb@dfa.state.ny.us me subjektin "Establishing Parentage" (Përcaktimi i atësisë/mëmësisë). Dërgoni një email sa më të detajuar që të jetë e mundur, në mënyrë që stafi t'ju japë një përgjigje të detajuar. Përfshini emrin tuaj të plotë, të dhënat e kontaktit dhe ID-në e çështjes së mbështetjes financiare për fëmijën, nëse e keni një të tillë.
- Telefononi linjën e ndihmës së HRA OCSS për të kërkuar një test ADN-je në numrin **929-221-5008**.
- Vizitoni Qendrën Fizike të HRA OCSS për Shërbimin e Klientit ose një Gjykatë për Çështjet Familjare. Vendndodhjet mund të gjenden në adresën <https://on.nyc.gov/contactocss>.
- Vizitoni faqen e internetit të HRA OCSS në adresën <https://nyc.gov/hra/ocss> për të mësuar më shumë rreth shërbimeve të mbështetjes financiare për fëmijën.

NYC
Human Resources
Administration
Department of
Social Services



NYCHRA



HRANyc



NYCHRA



NYCHRA

BK-6 (AL) 07/31/2024
(E) Rev. 07/2024

© E drejta e autorit 2024. Qyteti i Nju-Jorkut, Administrata e Burimeve Njerëzore/Departamenti i Shërbimeve Sociale Për leje për të shumëfishuar të gjithë ose një pjesë të këtij materiali, kontaktoni Administratën e Burimeve Njerëzore të Qytetit të Nju-Jorkut.